



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 2705/2026

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

**F T E S Ë**

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e tretë -III- të rregullt për vitin 2026 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 31.03.2026 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.
3. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të NPL Pastrimi Sha.
5. Informatë mbi përjashtimin e nxënësve në shkollën e mesme "Dardania"
6. Të ndryshme.

**Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-**

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.
- Materialin e informatës për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.

Hani i Elezit  
Data:-23.03.2026





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 27/16 /2026  
Data: 23.03.2026

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dytë -II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 26.02.2026, me fillim pune në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Senad Kalisi** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare në Drejtorinë e Arsimit), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2025.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.
4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës së paluajtshme.
5. Plani i biznesit të N.P.L. Pastrimi sh.a për vitin 2026.
6. Raporti financiar për vitin 2025 i N.P.L. "Pastrimi" sh.a.
7. Raporti i punës për planin lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2025.
8. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.
9. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson: për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin;

**Menduh Vlasi** thekson: në fund kam kërkuar prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kam parashtruar pyetje me ma sjellë raportin e fundit të Bifurkacionit për cilësinë e ujit.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë vërejtje; nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson: Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025 paraqet një dokument përmbledhës dhe analitik mbi veprimtarinë institucionale, vendimmarrjen dhe angazhimet e realizuara gjatë këtij viti, në ushtrimin e përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore të Kryetarit të Komunës. Ky raport pasqyron punën e bërë në drejtim të qeverisjes lokale, menaxhimit të resurseve publike dhe ofrimit të shërbimeve efikase për qytetarët. Gjatë vitit 2025, Komuna e Hanit të Elezit është përballur me sfida të ndryshme zhvillimore, ekonomike dhe sociale, por njëkohësisht ka shënuar përparim të dukshëm në fusha kyçe me interes publik. Përmes planifikimit strategjik, koordinimit të vazhdueshëm ndërinstitucional dhe bashkëpunimit konstruktiv me Kuvendin Komunal, drejtoritë komunale, institucionet qendrore, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, janë ndërmarrë iniciativa konkrete që kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Fokusi i punës së Kryetarit gjatë këtij viti ka qenë forcimi i transparencës dhe llogaridhënies institucionale, rritja e efikasitetit administrativ, zhvillimi i infrastrukturës lokale, përkrahja e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe krijimi i kushteve më të mira për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale. Vendime të rëndësishme janë marrë edhe në drejtim të menaxhimit financiar, planifikimit buxhetor dhe zbatimit të projekteve kapitale me rëndësi për komunën. Ky raport ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe transparente mbi rezultatet e arritura, aktivitetet e realizuara dhe sfidat e hasura gjatë vitit 2025, duke shërbyer njëkohësisht si dokument informues për qytetarët dhe si mjet reference për institucionet relevante. Ai reflekton angazhimin e vazhdueshëm të Kryetarit të Komunës për qeverisje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt interesit publik, si dhe vullnetin për përmirësim të vazhdueshëm të politikave dhe shërbimeve komunale në të ardhmen. Në material janë të përfshira edhe marrëveshjet të cilat janë të nënshkuara dhe projektet të cilat janë hartuar, që disa prej tyre janë realizuar e disa kanë mbetur në fazën e realizimit. Duhet ta keni parasysh, për shkak se është raport dhe nuk ndryshon puna që ka kaluar, por është raport që për shkak të transparencës e paraqesim si dokument për me parë se çka keni punuar në vitin 2025.

**Sead Vila** thekson: është e vërtetë që raporti i punës është voluminoz dhe normal që i ka përparësitë dhe ndoshta edhe mangësitë, por sido që të jetë, po të ndalemi pak më në detaje, gabimet ose mospërputhjet është mirë të përmirësohen gabimet teknike apo të sqarohet se cili është problemi që ka kësi mospërputhjes. Në faqe shtatë, te Zyra Ligjore, janë dy tabela dhe shihet te krahasimi që bëhet për vitin 2024 dhe 2025, dhe pjesa ku është diferenca është komplet me gabime, mungojnë shifra dhe nuk përputhen shifrat. Është mirë me u rregulluar kjo pjesë, se me siguri bartet në arkivë. Te tabela tjetër, vendimet dhe rregulloret të cilat janë bërë nga Zyra Ligjore, në qoftë se i referohemi si total, qoftë si vendime ose nëse i ndajmë sipas viteve, gjithashtu ka një mospërputhje. Rekomandoj që të rregullohen këto, sepse këto janë dokumente. Ka edhe disa gabime që i kam vërejtur edhe në disa drejtori e që për dikë mund të quhen teknike, por rekomandoj që të korrighohen.

**Menduh Vlashi** thekson: në shumicën e raporteve të drejtorëve nuk tregohen qartë, ashtu siç potencoi Kryetari, se raporti paraqet një pasqyrë të saktë të punëve të kryera dhe detyrave. Te shumica e drejtorive shënohet se kemi bërë trajnime, kemi bërë vizita, takime me këshillat e fshatrave, por nuk tregohet se sa takime janë bërë brenda vitit dhe çka është arritur me ato takime, sa trajnime janë bërë dhe cilat trajnime. Te raporti, sipas meje, nëse ka shifra duhet të bëhen krahasimet, që shumica e drejtorëve nuk e përdorin metodën e krahasimit, sepse raporti pikërisht këtë tregon: punën e kryer dhe sa është arritur pozitivisht prej vitit në vit apo sa kemi ngecur. Atë që e potencoi z. Sead Vila është ashtu: te Zyra Ligjore, me shkrim i ka në vitin 2025 një rregullore, për vitin 2024 katër, ndërsa në tabelar në vitin 2025 i ka tri, kurse në 2024 dy, pra nuk ka përputhje. Njësia e Burimeve Njerëzore, te shumica e procedurave të dështuara, unë nuk e kuptoj: katërmbëdhjetë kanë dështuar, katërmbëdhjetë janë realizuar. Nëse ka arsye, është mirë në raport me treguar se pse kanë dështuar. Administrata e përgjithshme ka takime të rregullta me këshillat e fshatrave, por në bazë të këtij raporti unë nuk e di sa takime janë mbajtur dhe pse janë mbajtur. Te Drejtoria për Buxhet dhe Financa edhe këtu nuk janë përdorur krahasimet, por do të ishte mirë që të sqarohet saktë te ekzekutimi i buxhetit suficiti, sepse është mjaft i madh, por është mirë me u sqaruar se pse kanë mbetur këto mjete financiare, pra në raport është mirë me shënuar se pse kanë mbetur suficit mbi 600 000 €. Në faqe 42 shënohet se kemi pasur ngritje të të hyrave, mirëpo unë nuk e kuptoj se a ka ngritje të të hyrave sepse janë shtuar bizneset, apo për shkak të inkasimit të borxheve, apo për shkak të rritjes zhvillimore. Potencohet se kemi bërë shqyrtimin e ankesave, por nuk shënohet se sa ankesa janë shqyrtuar, sa janë kthyer pozitivisht dhe sa janë kthyer negativisht. Drejtoria për Arsim, në materialin e KPF-së, shënon trajnimin e mësimitdhënësve të kimisë, biologjisë, ekologjisë, por nuk shënohet se për çka janë trajnuar. Nuk e pashë në material se sa kontrole janë bërë nëpër shkolla, që këtë e ka obligim shefi i Drejtorisë së Arsimit. Në faqe pesëdhjetë, te Drejtoria e Urbanizmit, nga gjashtëmbëdhjetë projekte që kanë qenë gjithsej, janë realizuar tetë projekte, që është një dështim i madh. Në plan të punës potencova që është mirë me planifikuar aq sa mundemi me realizuar, se dalim keq edhe ju si ekzekutiv edhe ne si kuvend. Te kërkesat e qytetarëve nuk e dimë sa kërkesa janë dhe sa janë kthyer pozitive e sa negative. Shënohet që inspektorja ka bërë inspektime, por nuk potencohet se sa inspektime dhe çka është vërejtur gjatë inspektimeve; është dashur të shënohet në raport. Te Drejtoria e Shëndetësisë, ku qëndron arsyeja që në vitin 2025 ka shumë më pak se në vitin 2024? Te Drejtoria për Zhvillim Ekonomik nuk është kuptuar se a janë të gjitha ato biznese që ekzistojnë apo që janë hapur për herë të parë në 2025 dhe sa janë shuar në vitin 2025. Te Drejtoria e Bujqësisë shënohet përgatitja e raportit për dëmet e shkaktuara nga ariu, por është dashur të dihet se a merren masa apo vetëm e keni për detyrë me e dërguar në Ministri. Te një pjesë e madhe e drejtorive është shënuar “vizita”, por nuk e dimë në raport se çka janë ato vizita. Te Drejtoria e Kulturës, në fillim janë përzier datat dhe është mirë me i ndarë punët dhe detyrat në kulturë, rini dhe sport.

**Basri Dernjani** thekson: është një raport i punës i cili ka qenë edhe vit zgjedhor dhe të gjithë e dimë që në vitin 2025 kanë qenë edhe zgjedhjet lokale. Qytetarët kanë dhënë një verdikt që kjo qeverisje meriton mandatin edhe për katër vite, prandaj unë vetëm ju uroj suksese.

**Resul Suma** thekson: nuk deshta me u kyçur te puna e raportit, por deshta një replikë për sqarim edhe për qytetarët. Te puna e 600 000 € që u potencua se ka mbetur suficit, është mirë që të sqarohet edhe para qytetarëve se nuk janë 600 000 € që kanë mbetur suficit, por 350 000 € janë obligime të cilat janë në pritje, pasi mjetet financiare nuk guxojnë me iu dalë kompanive pa i kryer projektet. Pasi është muaji i Ramazanit, kisha dashur që disa fjalë dhe propaganda që janë gjysmë të vërteta mos me shkuar te qytetarët ashtu.

**Menduh Vlashi** thekson: unë nuk e kam shënuar atë shifër mbi 600 000 €, por ju e keni shënuar dhe është suficit, dhe potencova se është mirë me u sqaruar në raport se pse kanë mbetur.

**Resul Suma** thekson: te suficiti shënohen 600 000 €, por dy apo tre rreshta më poshtë shënohet se 350 000 € janë obligime në pritje dhe që thua ti 600 000 € janë suficit, por kur të shpenzohet shuma prej 350 000 € që janë obligime në pritje, i bie që mbesin 250 000 €, dhe këtë shumë e ka sqaruar kryetari dhe drejtoresha në mbledhjen e kaluar dhe ato kanë mbetur mbetje të projekteve që ndoshta kanë kushtuar më lirë dhe tani është dashur me iu kthyer shtetit. Ato mjete të cilat kanë mbetur, në bazë të asaj që ne i kemi fituar një milion e dyqind e treqind mijë euro, nuk janë asgjë në bazë të planifikimit të cilin e kemi pasur vitin e kaluar.

**Sherif Bushi** thekson: Zyra Ligjore ka shënuar që në sektorin e arsimit kanë parashtruar padi ndaj komunës të gjithë punëtorët e arsimit dhe për shujta në komunë janë të gjithë nëpunësit civilë, nëpunësit publikë, zjarrfikësit dhe ish stafi politik i komunës. Pas marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, komuna ka parashtruar ankesë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë i ka kthyer disa aktgjykime në favor të komunës. A mundeni me na treguar se cilat aktgjykime janë prishur dhe cilit sektor i takojnë ato aktgjykime? Te një pikë tjetër e kam vërejtur riparimi dhe furnizimi me shtylla të betonit në rrugën "Lidhja e Prizrenit", te Lagjja Uji i Thartë, por është vendosur vetëm një shtyllë betoni dhe ajo është vendosur dy apo tri javë para zgjedhjeve komunale. Si lagje e kemi pritur atë vendim për me u bërë ndërrimi i atyre shtyllave, por ato shtylla nuk janë ndërruar të gjitha, por vetëm ajo shtyllë dhe kur është vendosur nuk është siguruar mirë. Ajo shtyllë, përveç që nuk e ka zgjidhur problemin e shtyllave të rrymës, paraqet rrezik, sepse është duke prekur me telat e rrymës me tension të lartë. Bëj apel që sa më parë me u rregulluar, sepse mund të sjellë ndonjë problem më të madh.

**Mehmet Ballazhi** thekson: është raport për punën të cilën ne e kemi bërë dhe kjo po më duket shumë kontraverse, sidomos z. Menduh Vlasi, në atë që po e kërkon dhe atë që po e potencon, sepse edhe potencon që mos bëni një dokument shumë voluminoz dhe njëkohësisht kërkon që të shënohet çdo vizitë, se për çka ka ndodhur ajo vizitë, mirëpo nëse shënohet secila vizitë del një dokument me pesëqind apo gjashtëqind faqe. Sa i përket shtyllave elektrike, në raport shënohet se çka është punuar, pra raporti është i vitit 2025. Se çka nuk është punuar, ne i marrim rekomandimet e juaja dhe do të punojmë në vitet në vijim. U potencua që shtylla është bërë dy muaj para zgjedhjeve dhe nuk besoj që e kanë bërë për me ta marrë votën tënde, sepse nuk je votues i yni dhe nuk ka pasur nevojë me vendosur shtyllë, por ne e shfrytëzojmë kohën kur mundemi me menaxhuar, pavarësisht a është Ramazan, a është koha e zgjedhjeve apo pas zgjedhjeve; ne i kryejmë punët tona. Te plani, unë ju kuptoj që jeni anëtarë të rinj të këtij legjislacioni dhe nuk e keni pasur planin këtu, por e keni në uebfaqe të komunës. Nëse doni me qenë më konkret, e keni në uebfaqe, dhe pse duhet patjetër që çdo legjislacion i ri me anëtarë të rinj me filluar prej zeros dhe pse me u kthyer në zero, por jemi mësuar me ecur përpara, sepse njëzet vite sa keni qenë gjithmonë u kthejshin në zero. Ne ju falënderojmë për rekomandimet, në ndonjë rast nëse nuk ka përputhje në shifra dhe për ide të reja për planin, ne kur ta bëjmë, por raporti është diçka që nuk ndryshon.

**Sherif Bushi** thekson: sa i përket asaj që a të votojmë apo nuk të votojmë, nuk duhet të ceket këtu, sepse je kryetar i të gjithëve, si i atyre që nuk të kanë votuar, ashtu edhe i atyre që të kanë votuar. Ajo shtyllë është vendosur dhe koha ka qenë atëherë kur është vendosur, ka qenë një muaj para zgjedhjeve dhe është duke paraqitur problem.

**Mehmet Ballazhi** thekson: nëse është bërë në vitin 2025 dhe është raport i vitit 2025, nuk ka asgjë të keqe, sepse ne e kemi bërë një raport dhe secili është qytetar dhe unë jam kryetar i kësaj komune, nuk ka ndonjë dallim. Ajo shtyllë është vendosur dhe nuk kam ndikuar për mos me u vendosur, mirëpo kur ju e përmendni që dy javë para zgjedhjeve, në mënyrë automatike të determinon se çka me menduar. Nuk është vendosur për vota, për shkak se ti dhe familja jote nuk jeni votues tonët, por ne kemi punuar aq sa kemi mundur me punuar dhe sigurisht kemi bërë edhe punë tjera ku nuk ka pasur votues tanë.

**Menduh Vlasi** thekson: e di që jam i ri, por në KPF e theksova që në uebfaqe duhet të jetë plani; nuk ka qenë, por nuk e di se kur e kanë publikuar, dje apo pardje. Drejtoresha për Shërbime Publike e ka potencuar "kontrata e realizuara", mirëmbajtja e ndriçimit publik; nuk dihet se çka është bërë: saldimi, regjistrimi i veturave dhe nuk e di a quhet raport.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson: përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam. Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

### 4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës së paluajtshme.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson: ky propozim ka për qëllim shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës së z. Driton Luri. Sipërfaqja e parcelës është 4.33 ari dhe kjo parcelë planifikohet për ndërtimin e tregut të gjelbër për produktet bujqësore për fermerët lokalë. Fjala është për parcelën në kuadër të oborrit të komunës. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim, mund të parashtroni.

**Menduh Vlasi** thekson: edhe në KPF e theksova që për këtë parcelë është marrë një vendim i Kuvendit të Komunës dhe është mirë që të konsultohet me juristët, sepse nuk është mirë me marrë vendim mbi vendim, pasi duhet të anulohet ai vendim për me u marrë vendimi tjetër.

**Nexhmedin Daci** thekson: edhe në KPF i tregova që nuk ka vendim, sepse i kemi kërkuar të gjitha vendimet dhe është vetëm parcela e z. Qamush Brava kur është shpronësuar, por kjo nuk është. Në vitin 2010 është bërë një marrëveshje për shpronësim, afati ka qenë dy vite, por nuk ka vendim për shpallje të interesit të përgjithshëm. Në vitin 2022 kemi bërë përsëri marrëveshje dhe i kemi kërkuar vendimin, por nuk është; ka vendim për shumë parcela tjera, por për këtë parcelë nuk ka.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË PRONËS SË PALUAJTSHME

### 5. Plani i biznesit të N.P.L. Pastrimi sh.a për vitin 2026.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Medina Imishti** thekson: te plani i biznesit të NPL Pastrimi po më intereson me i ditur të hyrat e kompanisë, ndërsa te shpenzimet për vitin 2026, në shumë prej 247 000 €, pra është një mospërputhje në mes të hyrave dhe të dalurave në shumë prej 5 204.48 €. Cili është burimi i financimit për mbulim të kësaj diference prej planifikimit të hyrave dhe prej planifikimit të dalurave? Si është e mundur që pagat për muajin janar 2026 të jenë më të vogla se për periudhën e njëjtë të vitit 2025? Në faqe nëntëmbëdhjetë është potencuar edhe bordi i drejtorëve, por a është përzgjedhur i njëjti bord? Nëse jo, kush janë anëtarët e rinj dhe kush i ka përzgjedhur? Nëse nuk e dini se si është planifikimi, pyetjet të cilat i parashtrova është mirë me m'i përcjellë me shkrim.

**Sead Vila** thekson: sa i përket NPL Pastrimit, çdo herë kam pasur lëvdata, qoftë si staf, qoftë si punëtorë në terren, dhe gjendja me NPL Pastrimin është e mirë, por vetëm një rekomandim e kam: nëse është bërë gabim, është mirë me u rregulluar. Te lista e punëtorëve, kategoria e punëtorëve të cilët janë punëtorë teknikë dhe ngarkues mbeturinash, nëse shihen pagat, bie në kundërshtim me vendimin e Qeverisë për pagën minimale. Nëse merret në gjashtëmujorin e vitit 2026, do të jetë 500.00 € bruto. Është mirë me u rregulluar kjo, se bie në kundërshtim me ligjin dhe duhet të rregullohet sipas vendimit të Qeverisë për pagën minimale.

**Ibadete Kuka** thekson: sa i përket grumbullimit të mbeturinave, propozoj që gjatë sezonës së verës nëpër fshatra me u bërë grumbullimi i mbeturinave dy herë në javë.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U MIRATUA PLANI I BIZNESIT TË NPL PASTRIMI SH.A PËR VITIN 2026

### 6. Raporti financiar për vitin 2025 i N.P.L. "Pastrimi" sh.a.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Bajrami** thekson: përveç materialit, diçka të veçantë nuk kam.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 7. Raporti i punës për planin lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Vjosa Rogaçi** thekson: diçka të veçantë nuk kam, përveç materialit që e kam përcjellë.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 8. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Amir Bushi** thekson: materialin e keni pranuar me kohë dhe, nëse nuk keni ndonjë propozim apo sugjerim, mund të parashtroni.

**Nora Xhoni** thekson: a keni numër të fëmijëve me autizëm të cilët janë jashtë shkollës? Sa është numri dhe a kanë mbështetje ata fëmijë?

**Amir Bushi** thekson: në Qendrën për Punë Sociale janë njëzet e shtatë të cilët marrin pagesë, por për fat të keq numri është në rritje.

**Menduh Vlashi** thekson: është shënuar se kemi mbajtur ligjëratat në shkollën fillore, por nuk dihet se për çfarë teme janë mbajtur ligjëratat.

**Amir Bushi** thekson: në mbledhje të KPF-së i dhatë vërejtje dhe unë i kam ndryshuar, por kur e kam pyetur sekretarinë e Kuvendit, ata më njoftuan që materiali ju ka përcjellë asamblistëve dhe koha ka qenë shumë e shkurtër.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 9. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson: vitin e kaluar gjithsej kanë qenë 27 aplikime për legalizim, kryesisht bëhet fjalë për shtëpi individuale; 18 janë legalizuar, kemi inkasuar të hyra prej 2 500 €, ndërsa nëntë aplikues janë në listë të pritjes për shkak të problemeve të cilat i kanë me pronat. Në vitin e kaluar, me datë 31 dhjetor, ka përfunduar vlefshmëria e Ligjit të Legalizimit, por në muajin janar Ministria e Planifikimit Hapësinor na ka njoftuar me vendimin e ri që zgjatet afati i legalizimit edhe për këtë vit, deri më 31 dhjetor 2026.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Visar Hasallari** thekson: e di që Kryetari i Komunës nuk ka të drejtë me favorizuar një kompani për tender publik, sepse është vepër penale, por ekzistojnë mundësitë ligjore për me i ndihmuar këta biznese, sepse në komunën tonë shumë pak biznese e dinë të drejtën e aplikimit në çështjen e prokurimit publik. Drejtorja për Zhvillim Ekonomik ka të drejtë që në buxhetin e ardhshëm ta propozojë në Kuvend dhe ne ta votojmë për ofrimin e shërbimeve të kompanive që japin konsulenca bizneseve për përgatitjen e dosjeve për tender. Komuna të tjera të Kosovës e kanë bërë këtë dhe kanë rezultuar me sukses.

**Shefket Lusnjani** thekson: kam një kërkesë nga banorët e fshatit Rezhancë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Një rrugë në mes të fshatit Rezhancë është duke u shembur asfalti. Kërkoj që në çdo gjashtë muaj të thirret instituti për me bërë analiza të ujit, për shkak se ka pasur reshje të shumta të shiut. Të gjithë e dinë se nga lagjja nën hekurudhë e andej, në momentin që fryjnë erërat, po mbesim pa rrymë; sidomos pengesë është fshati Glloboçicë dhe a kemi mundësi me bërë kërkesë që me u lidhur me rrejetin e tensionit të lartë dhe me u çkyçur prej Glloboçicës. Ka raste që ndalet rryma në Krivenik, elektrikistët të cilët vijnë me rregulluar e ndalin rrymën edhe në Gorancë; është mirë që ndalesa të bëhet vetëm për Krivenik e jo edhe për Gorancë. Në Gorancë hidhen mbeturinat e ngurta, por si fshat nuk lejojmë që me sjellë mbeturina edhe të tjera, por është mirë të pastrohen ato mbeturina që i kanë hedhur dhe ne t'i vendosim shenjat që është e ndaluar hedhja e mbeturinave të tjera.

**Sherif Bushi** thekson: pas reshjeve të shumta të shiut, një pjesë e rrugës "Imer Vila", ose më konkretisht ku banon familja Loku, ka filluar që të shembet dhe e rrezikon një shtëpi e cila është e vendosur në pjesën e poshtme të rrugës, por njëkohësisht rrezikon të gjitha ato shtëpi që kanë qasje në rrugë. Kërkoj që të dilet në vendin e ngjarjes dhe të shikohet mundësia për intervenim. Në rrugën "Lidhja e Prizrenit" kërkoj që të vendosen dy pasqyra në dy vende të rrezikshme, ku paraqet rrezik për shoferët dhe këmbësorët, për shkak se më herët kanë qenë të vendosura, por nuk di se prej kujt janë dëmtuar. Kërkesë kam prej banorëve të lagjes Rana, se e dimë që në këtë vit ka pasur reshje atmosferike të shiut dhe niveli i lumit Lepenc është rritur ndjeshëm, dhe e dimë që është bërë riparimi i hekurudhës dhe hekurudha është siguruar, por lumi Lepenc shkon gjithnjë e më shumë kah pjesa e rrugës; mirëpo kërkesë e banorëve është që të vendoset një mur mbrojtës. Te vendi i quajtur Dheu i Bardhë e dimë që është pjesë e Ministrisë së Infrastrukturës, por kërkoj që të kontaktoni me Ministrinë përkatëse që të bëhet një siguri më e madhe e asaj pjese, e jo vetëm me u pastruar, sepse edhe një sasi e ujit qëndron çdo herë.

**Mehmet Ballazhi** thekson: sa i përket elektrifikimit të KEDS-it, vazhdimisht kemi bërë kërkesa dhe i kemi dërguar foto dhe incizime, por nuk kanë ndërmarrë masa për me i rregulluar ato shtylla. Ju mund të parashtroni kërkesa dhe, përmes kërkesave të juaja, ne i përcjellim. Te shembjet e dheut gati se ka gjithandej, e kjo në fshatin Rezhancë është me urgjencë; pastaj shembjet e dheut te Uji i Thartë i kanë pastruar, por varet prej tyre se a munden me vendosë rrjetë, sepse nuk është kompetencë e jona. Te lumi Lepenc është një projekt i Bankës Botërore dhe i Bashkimit Evropian që ne nuk mundemi me intervenuar me buxhetin tonë, por është ai projekt që ne jemi duke pritur, që është për pastrimin e zonave të kontaminuara prej azbestit, e në kuadër të kësaj ka me u rinovuar; por është projekt që nuk mund të realizohet shpejt, për shkak se do të jetë marrëveshje ndërkombëtare që kalon përmes Qeverisë në Kuvend. Është projekt që nuk varet prej nesh, por jemi duke pritur. Problem kemi edhe te Bllaca 99 për shkak të daljes së lumit prej shtratit. Vendosja e pasqyrave është çështje e kontratave, që është fillimi i vitit dhe buxhetin nuk e kemi.

**Basri Dernjani** thekson: për mbledhjen e radhës kërkoj që të hyjë në rend dite një pikë për NPL Pastrimi, për shkak se paga ishte nën minimale dhe, pasi që jemi aksionarë, besoj që mund ta gjejmë ndonjë zgjidhje.

**Kryesuesi** thekson: kjo është shqetësim për gjithë neve, por duhet t'i shikojmë mundësitë buxhetore.

**Resul Suma** thekson: pozitat e lira në QKMF – Hani i Elezit, a i ka planifikuar Ministria apo në bazë të nevojave janë planifikuar nga Drejtoria e Shëndetësisë? Çka është planifikuar, kur do të shpallet konkursi për ato pozita, sepse ka shumë interesim edhe prej stafit mjekësor.

**Mehmet Ballazhi** thekson: Ministria e Shëndetësisë e ka përcaktuar se çka do të ketë. Ne e kemi kërkuar çdo herë për mjekë, laborantë dhe infermierë. Ata na i kanë lejuar pozitat sipas atyre që kanë vlerësuar, por disa pozita nuk lejohen për shkak se legjislacioni nuk i lejon. Unë kam dhënë leje që me i shpallur, por ende është problem prej Ministrisë përkatëse, sepse ata duhet ta japin lejen për hyrje në sistem. Deri në fund të muajit mars e kemi kontratën me "Islamic Relief" dhe, sapo të shkojnë ata, kemi me pasur mungesë të stafit.

**Menduh Vlasi** thekson: sa i përket pyetjes së dytë që e kam parashtruar, unë kam kërkuar raportin e fundit kur është dhënë dhe në bazë të kësaj e kuptova që nuk ka pasur raport asnjëherë dhe, nëse nuk ka pasur asnjëherë, më tregoni që nuk kemi raport. Është mirë me kërkuar prej kompanisë "Bifurkacioni", sepse ata japin raporte një herë në dy javë apo një herë në muaj në Kaçanik apo në Ferizaj. Raportin e kërkoja në mënyrë që me ditur se sa kohë ka që nuk kanë dhënë raport. Projekti i zgjerimit të rrugës Ekzoti 99, a ka përfunduar dhe a është bërë pranimit teknik? Shtegu i këmbësorëve për Paldenicë, a ka përfunduar dhe a është bërë pranimit teknik? Kërkoj përgjigje me shkrim për lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë ndërtuar rreth magjistrales, duke nisur prej restorantit të Kukëve e deri te autolarja.

**Nexhmedin Daci** thekson: është mirë me i konkretizuar objektet, sepse unë nuk mundem me t'i përcjellë të gjitha lejet e Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:32.

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**





**Republika e Kosovës / Republic of Kosova**  
**Komuna - Municipality**  
**Hani i Elezit**



---

01/Nr. \_\_\_\_\_/2026

<b>DATA:</b>	13.03.2026
<b>PËR:</b>	Komitetin për Politik dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës.
<b>NGA:</b>	Komitetit për Komunitete
<b>LËNDA:</b>	<b>Shkresë:-</b> Raporti i Punës së komitetit për komunitete për vitin 2025

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim raportin e punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.

Me respekt

## **RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2025**

Komiteti për Komunitete është themeluar nga Kuvendi i Komunës me datë 30.12.2021 prej pesë anëtarëve: Resul Suma, Ajnure Thaçi, Hanumshahe Dibrani, Zaim Bela, Mefail Suma.

Për shkak të vdekjes të kryesuesit të Komitetit për Komunitete Mefail Suma është zëvendësuar me antarin e ri të komitetit nga Shoqëria Civile – Sulejman Vila gjithashtu Kryesues me unanime të votave u zgjodh Resul Suma.

Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2025 ka planifikuar t'i mbajë 12 mbledhje.

Gjatë viti 2025 Komiteti për Komunitete ka mbajtur 9 mbledhje. Mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë monitoruar nga OJQ-të dhe OSBE-ja.

Komiteti për Komunitete në vazhdimësi ka përcjell punën e kuvendi të komunës dhe ka dhënë propozime dhe sugjerime.

Nr.	MBLEDHJET E RREGULLTA TË MBAJTURA SIPAS PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2022	RENDI I PUNËS PËR MBLEDHJET E MBAJTURA PËR VITIN 2023	VËREJTJET, SHQETSIMET E DHËNA
1	Mbledhja e parë e mbajtur me datë: 30.01.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njohuri me kompetencat e Komitetit për Komunitete</li> <li>2. Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë.</li> <li>3. Rastet sociale ne Komunën e Hanit Elezit</li> <li>4. Takim me drejtorin e QPS.</li> <li>5. Eventuale</li> </ol>	Në këtë mbledhje është diskutuar për problemet dhe gjërat që e shqetësojnë komunitetin në shëndetsi dhe masat e ndërmarra nga qeverisja aktuale për përmirsimin e tyre.
2	Mbledhja e dytë e mbajtur me datë: 26.02.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratim i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me drejtorinë e Administratës.</li> <li>3. Identifikimi dhe parandalimi i dukurive negative në Komunën tonë.</li> <li>4. Eventuale.</li> </ol>	<p>Janë diskutuar dhe dhënë propozime të ndryshme sa i përket dukurive negative si p.sh punëtori dhe ligjerata të ndryshme për nxënësit e Shkollës Filllore.</p> <p>Gjithashtu është diskutuar edhe për punën e administratorëve.</p>
3	Mbledhja e tretë e mbajtur me datë: 19.03.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me Kryesuesin e Këshillit të Prindërve,të Shkollave.</li> <li>3. Takim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomi .</li> <li>4. Takim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimit Rural.</li> <li>5. Eventuale</li> </ol>	Pika 2 e mbledhjes nuk është mbajtur për shkak të mungesës së personit në fjalë. Është diskutuar për subvencionet e dhëna në bujqësi dhe planin e Drejtorisë së Bujqësisë për vitin 2025 dhe 2026.
4	Mbledhja e katërt e mbajtur me datë: 29.04.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me Zyrtarin e Zyrës për barazi gjinore. (Lufta kundër dhunës)</li> <li>3. Takim me Zyrtarin e Zyrës Kadastrale</li> <li>4. Takim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.</li> <li>5. Eventuale</li> </ol>	<p>Me drejtorinë e Arsimit është diskutuar për problemet dhe gjërat që e shqetësojnë komunitetin në tërësi për arsimin dhe shkollimin e të rinjve tanë dhe zgjidhjet apo politikat e drejtorisë karshi këtyre problemeve.</p> <p>Gjithashtu është kërkuar nga zyrtari i Zyres Kadastrale se si qendrojnë punet me</p>

			problemet pronesore ne Hanin e Elezit.
5	Mbledhja e pestë e mbajtur me datë: 28.05.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me Kryesuesit e dy Komiteteve Konsultative</li> <li>3. Takim me përfaqësuesit e dy Këshillave të Fshatrave.</li> <li>4. Takim me përfaqësuesin e Aleancës së Bizneseve.</li> <li>5. Eventuale</li> </ol>	Pika 2,3,4 nuk është diskutuar për shkak mungesës së akterëve në fjalë. Është diskutuar për probleme të ndryshme si qentë endacak dhe disa të tjera që e shqetësojnë komunitetin në të cilin jetojmë.
6	Mbledhja e gjashtë e mbajtur me datë: 25.06.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me Nënkryetarin e Komunës.</li> <li>3. Takim me përfaqësuesin e Shoqatës Handikos Hani i Elezit.</li> <li>4. Eventuale</li> </ol>	Më së shumti është diskutuar për problemet me të cilat përballen shoqata Handikos dhe personat me aftësi të kufizuara dhe zgjidhjet në të cilat komuna ka ofruar dhe shqyrtimi i mundësive të komitetit për të rekomanduar zgjidhje për Kuvend
7	Mbledhja e shtatë e mbajtur me datë:30.07.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me Zyrтарin e Zyrës së Prokurimit.</li> <li>3. Takim me Drejtorin e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.</li> <li>4. Eventuale.</li> </ol>	-Pika 2 dhe 3 nuk është mbajtur për shkak të mungesës së akterëve në fjalë. Është diskutuar për probleme të ndryshme të cilat e shqetësojnë komunitetin.
8	Mbledhja e tetë e mbajtur me datë:20.08.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me zyrtarin e zyrës për Informim dhe Transparencë.</li> <li>3. Takim me drejtorin e drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë.</li> <li>4. Takim me përfaqësuesin e BI Hani i Elezit.</li> <li>5. Eventuale</li> </ol>	Pika 2, 3, 4 nuk është mbajtur për shkak mungesës së aktërevë në fjalë.

9	Mbledhja e nëntë e mbajtur me datë:24.09.2025	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</li> <li>2. Takim me zyrtarin e Zyres Ligjore</li> <li>3. Takim me drejtoreshën për Buxhet dhe financa.</li> <li>4. Eventuale.</li> </ol>	<p>Pika 2 dhe 3 nuk është mbajtur për shkak mungesës së akterëve në fjalë.</p> <p>Është diskutuar për rënien e nr. Të nxënësve nëpër shkollat e Hanit Të Elezit.</p>
---	---	--	--

Rekomandim i përhershëm: drejtorët e drejtorive të marrin pjesë në mbledhjet e komitetit për komunitete sipas pikave të parapara.



Republika e Kosovës - Republik of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02/Nr. \_\_\_\_\_/2025

<i>DATA:</i>	13.03.2025
<i>PËR:</i>	Komitetin për Politik e Financa dhe Kuvendin e Komunës
<i>NGA:</i>	Kryetari i Komunës z.Mehmet Ballazhi
<i>LËNDA:</i>	Shkresë përcjellëse: Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim informatën për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.

Me respekt

**INFORMATË PËR AKTIVITETE E KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË  
BASHKËSI PËR VITIN 2025**

Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive në komunën e Hanit të Elezit për vitin 2025 ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje të rregullta.

Në takimet e rregullta të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive zakonisht marrin pjesë:

1. Kryetari i komunës si kryesues i këshillit
2. Komandanti i stacionit policor
3. Përfaqësuesi i policia kufitare vija e gjelbërt
4. Përfaqësuesi i këshillit të bashkësisë islame
5. Kryesuesi i komitetit për komunitete
6. Përfaqësuesi për barazi gjinore
7. Drejtori i drejtorisë për arsim
8. Përfaqësuesi i këshillit të prindërve
9. Përfaqësuesi i FSK-së
10. Drejtori i drejtorisë për shërbimeve publike dhe emergjencë
11. Përfaqësuesi i KVRL-së

## Çështjet të cilat u trajtuan:-

- Siguria në komunën tonë.
- Siguria në Komunikacion.
- Çështja e investimeve kapitale që i ka komuna dhe pronat të cilat i posedon janë tu pasur shumë dëmtime siç po e shohim te parku i qytetit, parku Bllaca 99, te parku te Ura e Seçishtës dhe dëmtimet tjera që po bëhen në vazhdimësi në prona publike, dhe është kërkuar prej policisë që të ketë një angazhim pak më të madh sa i përket kësaj çështje.
- I është rekomanduar policisë për çështjen e parkingu që është për persona me aftësi të kufizuara që mos të jetë i zënë.
- Është rekomanduar që policia të vazhdon të qendronë në pikën te shkolla fillore “Ilaç Thaçi në dy ndërrime.
- Është diskutuar çështja e dukurive negative edhe nëpër fshatra , droga, bixhozi teknologjik dhe është kërkuar nga policia që t’i njofton njësitet përgjegjëse të policisë për këtë çështje dhe të bashkëpunon me qytetarë për këtë çështje. Nga Policia e Kosovës janë mbajtur nëpër shkolla ligjërata që kanë të bëjnë me sigurinë. Ligjërata për dukuritë negative.
- Vendosija e zebrave.
- Është diskutuar çështja e qenve endacak por nuk kemi mundur me bërë asgjë për shkak se në takimet që kemi pasur është diskutuar si ide që kjo çështje me qenë në nivel rajonal.
- Çështja e migrantëve ilegal.
- Çështja e dëmtimit të ndriçimit publik te rruga “Ekzoti 99”.
- Çështja e rrugës Hani i Elezit –Gorancë-Gllloboçicë.
- Për çështjen e zjarreve komuna ka kërkuar prej policisë dhe administratorëve të lagjeve që për këtë pikë të jemi shumë bashkëpunues.
- Te pjesa në mes të kufirit të Maqedonisë dhe kufirit të Kosovës ka ankesa prej banorëve se në momentin që ka shumë kamionë i fillojnë

sirenat dhe është mirë me vendosur një shejë që me ndaluar. Rruga që shkon në drejtim të lagjes Vlash është mirë të vendoset një shejë që është rrugë pa dalje .